



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit



Nr.06/ 610 2026
Data: 22.01.2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 neni 17, Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës neni 19 si dhe Udhëzimi Administrativ nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna neni 17, kryetari i Komunës shpallë për diskutim publik Raportin e Studimeve të Trashëgimisë Natyrore në Territorin e Komunës Hani i Elezit të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.

NJOFTIM

SHPALLJE PUBLIKE DHE PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Komuna Hani i Elezit përmes këtij njoftimi fton dhe njofton trupat konsultative, publikun e gjerë, ekspertët e fushave dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë dhe japin kontributin e tyre në aspektin e vërejtjeve, sugjerimeve, propozimeve dhe plotësimeve të Raportit të Studimeve dhe Evidentimit të Vlerave të Trashëgimisë Natyrore në Territorin e Komunës Hani i Elezit të propozuara për Mbrojtje Ligjore nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.

Debat publik do të zgjatë 30 dite nga data **03.02.2026**.

Shqyrtimi kryesor publik do të mbahet më dt.**03.02.2026** me fillim nga ora 10:30 në sallën e takimeve të Asamblesë Komunale.

Raportin e studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në territorin e Komunës Hani i Elezit të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje Ligjore mund ta gjeni në web faqen e Komunës në linkun: <https://hanieliezit.rks-gov.net/raporti-i-evidentimit-te-vlerave-natyrore-ne-rrethinen-e-hanit-te-elezit-2024> i cili do të jetë aty nga dt.03.02.2026.

Komentet, vërejtjet, propozimet si dhe sugjerimet e juaja mund t'i drejtoni në email adresën: **fatbardha.h.bushi@rks-gov.net** ose mund t'i dorëzoni në kopje fizike në Zyrën e Zyrtares Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit-Fatbardha Bushi.

Ju lutemi për prezencë dhe kontribut.

